



Menaxhimi financiar dhe transparencë në ndërmarrjet publike

Raport tematik

12/2022

Përmbledhje ekzekutive

Ndërmarrjet publike qendrore në Kosovë vazhdojnë të operojnë me probleme të ndryshme menaxheriale dhe operative, mbingarkesë të stafit, keqmenaxhime financiare, e të tjera. Ngjashëm, ndërmarrjet më të mëdha publike në Kosovë thuajse në vazhdimësi kanë vepruar me humbje viteve të fundit, për çka një numër i tyre në vijimësi kanë pranuar subvencione nga qeveria. Ndërmarrjet publike nuk kanë pasur planifikim strategjik, për çka, sikur në rastin e Telekomit, nga mos kryerja e investimeve kapitale, e njëjta nuk ka arritur ta ruajë pozicionin e saj të mëparshëm në treg. Kurse, te ndërmarrjet publike të ujit, problem i theksuar del të jetë dhe shkalla e faturimit, ku për pjesën më të madhe të tyre, ajo ende mbetet nën 50% që nga viti 2010. Përkundër gjithë kësaj, pagat në këtë sektor janë rritur në vazhdimësi, ku paga mesatare është dy herë më e lartë se ajo në sektorin privat në Kosovë dhe më e lartë se pagat në pjesën tjetër të sektorit publik.

Po ashtu, tek ndërmarrjet publike qendrore, nga të dhënat e vitit 2017, vërehet se numri më i madh i të punësuarve janë burra. Tek ndërmarrjet sikur KEK-u, punësimi i grave është vetëm në nivelin 5.5%, tek "Infrakos" 6%, KRU "Prishtina" 12%, Telekomit 26%, etj.

Ndërmarrjet publike qendrore kanë po ashtu probleme të theksuara me transparencën, ku një numër i madh i dokumenteve që do të duhet të ishin publike në faqen e tyre zyrtare në internet mungojnë si publikim. Në këtë drejtim nuk bën përjashtim as Njësia për Politika dhe Monitorimin të Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, e cila dokumentet e fundit të vendosura në faqen e saj që lidhen me ndërmarrjet publike janë të vitit 2018.¹ Kjo njësi nuk publikon tash e disa vite as raportin e performancës për ndërmarrjet publike, ndonëse kjo obligohet me Ligjin për Ndërmarrjet publike.

¹ Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike. Faqja zyrtare. Pjesa e dokumenteve. Burimi: <https://bit.ly/3FJEaM8>

Menaxhimi financiar dhe transparenca nëndërmarrjet publike

Përmbajtja

Hyrje	5
Performanca e ndërmarrjeve publike qendrore	5
Performanca financiare	13
› Performanca financiare e sektorit të ujërave	14
› Shkalla e faturimit dhe arkëtimit të shërbimeve nga ana e sektorit të ujërave	14
› Performanca financiare e sektorit të telekomunikimit dhe shërbimeve postare	16
› Performanca financiare e sektorit të transportit hekurudhor	17
› Performanca financiare e sektorit të energjisë dhe minierave	18
› Performanca financiare e ndërmarrjeve multisektoriale	20
› Performanca financiare e sektorit të mbeturinave	21
Numri i punëtorëve të ndërmarrjeve publike	22
Gjetjet kryesore të Zyrës Kombëtare të Auditimit në NP	23
Transparenca e ndërmarrjeve publike	24
Përfundim	26
Aneks	27

Hyrje

Ndërmarrjet publike në Kosovë mbulojnë pjesë të rëndësishme të shërbimeve publike për qytetarë, si furnizimi me ujë, mbledhja e mbeturinave, prodhimi i energjisë elektrike, transporti, telekomunikacioni, etj. Mirëpo, ndërmarrjet publike në Kosovë përballen me probleme të shumta, siç janë mbingarkesa e stafit apo performanca e dobët, konkretisht operimi me humbje.²

Në Kosovë janë gjithsej 23 ndërmarrje publike qendrore (shih aneksin), të cilat janë në pronësi të Qeverisë së Kosovës, në të cilat ajo e ushtron të drejtën e aksionarit përmes bordeve të zgjedhura. Tek këto ndërmarrje bëjnë pjesë edhe ndërmarrjet rajonale të ujitjes dhe ujësjellësit, pasi që uji si burim është pasuri kombëtare dhe e drejta e menaxhimit i është bartur kompanive rajonale të ujit të cilat janë në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Komunitetet kanë të drejtë të përfaqësohen me nga një anëtar në bordet e këtyre ndërmarrjeve.³

Ndërmarrjet publike, në baza tremujore, raportojnë tek Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP), e cila pastaj raporton në Zyrën e Kryeministrit/es. Kjo e fundit, në baza vjetore, përgatit raport të performancës, i cili fillimisht miratohet në kabinetin qeveritar dhe pastaj procedohet për diskutim në Kuvendin e Kosovës.⁴

Në këtë raport, Institutit GAP analizon performancën dhe sfidat e ndërmarrjeve publike qendrore, meqë të njëjtat janë më të mëdhatë si për nga shtrirja dhe të hyrat dhe njëherit me më shumë probleme në operim. Raporti analizon të hyrat dhe shpenzimet që kanë këto ndërmarrje, sfidat dhe parregullësitë që i kanë karakterizuar në vitet e fundit dhe nivelin e transparencës së tyre.


-
- ² Komisioni Evropian. Raporti për vendin 2022. Burimi: <https://bit.ly/3Wcgsh8>
- ³ Gazeta Zyrtare e Kosovës. Ligji për ujrat në Republikën e Kosovës. Neni 1. Burimi: <https://bit.ly/3HIFWin>
- ⁴ Gazeta Zyrtare e Kosovës. Ligji për Ndërmarrjet Publike. Neni 8. Burimi: <https://bit.ly/3hjz8N9>

Performanca e ndërmarrjeve publike qendrore

Performanca financiare e ndërmarrjeve publike është një faktor shumë i rëndësishëm që duhet të merret parasysh kur bëhet fjalë për menaxhimin efikas të një ndërmarrjeje. Kjo performancë financiare mund të matet duke përdorur disa indikatorë kyç, siç janë: të hyrat, shpenzimet, fitimi apo humbja neto e ndërmarrjeve gjatë vitit, etj.

Në Kosovë janë 21 ndërmarrje publike qendrore. Ky raport analizon 18 prej tyre të cilat monitorohen nga Ministria e Ekonomisë (ME), gjegjësisht NjPMNP në kuadër të kësaj ministrie. Nga ndërmarrjet e monitoruara nga NjPMNP nuk përfshihet Ndërmarrja e re Energjetike e Kosovës (NKEC), për shkak se mungojnë të dhëna rreth operimit të saj, ndërkaq, nga dy ndërmarrjet tjera qendrore Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Aeroporti i Prishtinës monitorohen nga institucione tjera qendrore dhe jo NjPMNP. Në vitin 2020, 17 ndërmarrjet së bashku, kishin punësuar rreth 11,541 punonjës, kishin rreth 329 milionë euro të hyra dhe rreth 333 milionë euro shpenzime. Humbjet me të theksuara i kishte “Telekomi i Kosovës” me 16.6 milionë euro, e cila humbje ishte neutralizuar në nivel të sektorit nga performanca tejet e mirë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) me rreth 24 milionë euro fitim. Duhet të theksohet se tek shpenzimet operative të ndërmarrjeve hyn edhe linja e amortizimit të aseteve, e cila tek disa ndërmarrje ka vlerë tejet të lartë dhe shkak i saj, ndërmarrja mund të dal me performancë negative gjatë vitit.

Figura 1. Të hyrat, shpenzimet dhe fitimi i ndërmarrjeve publike, 2021




Burimi: Instituti GAP, bazuar më të dhënat e NjPMNP

Gjatë vitit 2021, 11 ndërmarrje kishin rritje të të hyrave krahasuar me vitin 2020. Rritje më të theksuar të të hyrave kishte Trepça⁵, Posta e Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), etj. Tek KEK-u, ndikim kishte rritja e theksuar e çmimit të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare gjatë pjesës së fundit të vitit 2021, ndërkaq, tek ndërmarrjet tjera ishte edhe efekti i bazës së ulët gjatë vitit 2020, meqë në atë vit kishte rënie të theksuar të të hyrave për shkak të pandemisë COVID-19.

⁵ Vetëm me ndërrimin e statusit të “Trepçës” në 2018, kjo ndërmarrje ka filluar të përfshihet në raportet vjetore të performancës së NjPMNP, mirëpo “Trepça” ka marrë subvencione nga qeveria në vazhdimësi; cka evidentohet edhe në këtë raport.

Figura 2. Rritja e të hyrave të ndërmarrjeve, 2019-2021




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Ndërkaq, nga analizimi i të hyrave të 15 ndërmarrjeve për të cilat ekzistojnë të dhëna më të plota, rezulton se në periudhën 2015-2020, vetëm KRU "Prishtina" ka pasur rritje pozitive të të hyrave nga viti në vit. Ndërkaq, Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive ShA (KMDK) dhe KRU "Gjakova" kanë pasur poashtu rritje pozitive deri në vitin 2019, meqë në vitin 2020 ishte edhe përhapja e pandemisë COVID-19, ku qytetarëve u ishte mundësuar shtyerje për kryerjen e obligimeve ndaj ndërmarrjeve, cka ka ndikuar edhe në të hyrat e tyre. Kurse, të gjitha ndërmarrjet tjera kanë pasur performancë të luhatshme.


Burimi:
Instituti GAP duke
përdorur të dhënat
e NjPMNP

Figura 3. Rritja e të hyrave të ndërmarrjeve publike nga viti në vit (%), 2016-2020



Në anën tjetër, sa i përket shpenzimeve, nga 15 ndërmarrjet për të cilat ekzistojnë të dhëna më të plota, vetëm Telekom i Kosovës ka pasur rënie të vazhdueshme të shpenzimeve vjetore. Ndërkaq, tek ndërmarrjet tjera vërehen luhajtje në këtë aspekt. Në vite të caktuara, sikurse tek KRU "Hidrodrini" dhe KU "Drini i Bardhë", në vitin 2019 në krahasim me 2018, shpenzimet janë rritur për 65%, respektivisht 64%.

Figura 4. Rritja e shpenzimeve të ndërmarrjeve publike nga viti në vit, 2017-2020



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Tek ndërmarrjet publike të ujit, problem i theksuar është edhe shkalla e faturimit, ku në pjesën më të madhe të tyre ajo është nën 50%. Tek ndërmarrjet më të mëdha, sikurse KRU "Prishtina", në vitin 2020, shkalla e arkëtimit ishte vetëm 42%, ndërsa edhe tek KRU "Bifurkacioni" dhe KRU "Hidrodrini" shkalla e faturimit ishte 37%, respektivisht 41%.

Ndërkaq, sa i përket arkëtimit, disa kompani rajonale të ujësjellësit (KRU), sikurse ajo e Mitrovicës dhe "Bifurkacioni" kanë shkallë më të ulët të arkëtimit me 72%. Më mirë në këtë aspekt qëndrojnë KRU "Gjakova" dhe KRU "Hidroregjioni Jugor" me shkallë të arkëtimit prej 95%, respektivisht 92%.


Tabela 1. Faturimi dhe arkëtimi nga ndërmarrjet publike

Ndërmarrjet	Faturimi i shërbimeve (%) në 2020	Arkëtimi (%) në 2020
KRU "Prishtina"	42	83
KRU "Hidromorava"	53	86
KRU "Hidroregjioni Jugor"	45	92
KRU "Mitrovica"	47	72
KRU "Hidrodrini"	41	86
KRU "Gjakova"	58	95
KRU "Bifurkacioni"	37	72
KU "Drini i Bardhë"	100	63
KU "Dukagjini"	100	88

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Ndër vite, ndërmarrjet publike kanë ofruar paga më të larta se pjesa tjetër e sektorit publik, si dhe paga mesatare është thuhetse dyfish më e lartë se ajo e sektorit privat. Nga viti 2012 deri në vitin 2020, paga mesatare tek ndërmarrjet publike është rritur në vazhdimësi.


Figura 5. Niveli i pagave tek ndërmarrjet publike, sektori publik dhe privat, 2012-2021



Burimi: Instituti GAP sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Tek 17 ndërmarrjet e përfshira në këtë raport, paga mesatare tek disa ndërmarrje del të jetë edhe për 50% më e lartë se mesatarja e vet sektorit. Konkrektisht, tek ndërmarrjet sikurse KEK-u, e cila në vitin 2020 kishte të punësuar 3,884 persona, paga mesatare ishte 1,162 euro, ndërkaq tek Telekom i Kosovës me 2,288 persona të punësuar, paga mesatare ishte 955 euro. Dallime të theksuara në pagën mesatare vërehen dhe tek ndërmarrjet e nën-sektorit të njëjtë, konkretisht, tek nën-sektori i ndërmarrjeve që merren më menaxhimin e ujërave. Përderisa tek KRU Prishtina, paga mesatare është 863 euro, tek KRU Bifurkacioni, paga mesatare del të jetë 469 euro.

Figura 6. Numri i punëtorëve dhe pagat mesatare në ndërmarrjet publike qendrore



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Po ashtu, në vazhdimësi, disa ndërmarrje publike kanë përfituar subvencione nga qeveria. Nga viti 2014, meqë nuk ka të dhëna publike më të hershme, në vijimësi, Trepça ka pranuar rreth 5 milionë euro në vit si subvencione direkte nga qeveria. Ngjashëm, edhe TrainKos dhe InfraKos kanë pranuar nga 500 deri 1 milion euro në vit. Ndërkaq, ndërmarrjet e ujit dhe për menaxhimin e mbeturinave, së bashku kanë marrë si subvencione rreth 1 milion euro në vit.⁶

Po ashtu, tek këto ndërmarrje publike, nga të dhënat e vitit 2017, del se numri më i madh i të punësuarve janë burra.

Tabela 2. Punësimi në ndërmarrjet publike qendrore sipas gjinisë, 2017

	2017 (%)	
	Gra	Burra
Ndërmarrjet publike		
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK)	5.5	94.5
“Telekomi i Kosovës” ShA (TK)	26	74
“Posta e Kosovës” ShA (PK)	23	77
“Trainkos” ShA	11	89
“Infrakos” ShA	6	94
Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive ShA (KMDK)	13	87
KRU “Prishtina”	12	88
KRU “Hidromorava”	14	86
KRU “Hidroregjioni Jugor”	13	87
KRU “Mitrovica”	6	94
KRU “Hidrodrini”	8	92
KRU “Gjakova”	16	84
KU “Drini i Bardhë”	21	79
KU “Dukagjini”	10	90
NH “Ibër – Lepenci”	14	86

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

⁶ Kalkulim i Institutit GAP bazuar në raportet nëntëmujore të Thesarit (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve).

Performanca financiare

Tabelat e paraqitura në kapitullin e mëposhtëm paraqesin një pasqyrë më të detajuar të gjendjes financiare dhe sfidave me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet publike të Kosovës.

Tabela 3. Performanca financiare e ndërmarrjeve publike që bëjnë pjesë në sektorin e ujërave

Burimi:
Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Ndërmarrjet	2019	2020	Ndryshimi në përqindje
Të hyrat ('000 euro)			
KRU "Prishtina"	17,491	17,702	1.21% ▲
KRU "Hidromorava"	2,841	2,630	-7.43% ▼
KRU "Hidroregjioni Jugor"	5,508	5,688	3.27% ▲
KRU "Mitrovica"	6,218	6,166	-0.84% ▼
KRU "Hidrodrini"	4,441	4,990	12.36% ▲
KRU "Gjakova"	5,238	5,141	-1.85% ▼
KRU "Bifurkacioni"	2,402	2,501	4.12% ▲
KU "Drini i Bardhë"	456	379	-16.89% ▼
KU "Dukagjini"	811	829	2.22% ▲
Gjithsej të hyrat	45,406	46,026	1.37% ▲
Shpenzimet në staf ('000 euro)			
KRU "Prishtina"	5,424	5,769	6.36% ▲
KRU "Hidromorava"	1,244	1,280	2.89% ▲
KRU "Hidroregjioni Jugor"	2,334	2,372	1.63% ▲
KRU "Mitrovica"	1,888	1,915	1.43% ▲
KRU "Hidrodrini"	1,688	1,673	-0.89% ▼
KRU "Gjakova"	2,376	2,414	1.60% ▲
KRU "Bifurkacioni"	1,230	1,193	-3.01% ▼
KU "Drini i Bardhë"	125	125	0.00% ■
KU "Dukagjini"	463	512	10.58% ▲
Gjithsej shpenzimet në staf	16,772	17,253	2.87% ▲
Fitimi/humbja neto ('000 euro)			
KRU "Prishtina"	-28	428	1628.57% ▲
KRU "Hidromorava"	202	77	-61.88% ▼
KRU "Hidroregjioni Jugor"	15	55	266.67% ▲
KRU "Mitrovica"	181	-314	-273.48% ▼
KRU "Hidrodrini"	214	327	52.80% ▲
KRU "Gjakova"	112	-493	-540.18% ▼
KRU "Bifurkacioni"	-51	31	160.78% ▲
KU "Drini i Bardhë"	7	-15	-314.29% ▼
KU "Dukagjini"	17	5	-70.59% ▼
Gjithsej fitimi/humbja	669	101	-84.90% ▼

Performanca financiare e sektorit të ujërave

Sektori publik i ujërave në Kosovë momentalisht përbëhet nga nëntë kompani, shtatë prej të cilave janë kompani të ujësjellësit që përqendrohen në furnizimin, menaxhimin dhe kontrollimin e cilësisë së ujit për qytete dhe zona të tjera të banuara, si dhe nga dy kompani të ujitjes të cilat kanë si qëllim ujitjen e tokave bujqësore.

Nga të gjitha ndërmarrjet në sektorin e ujërave, KRU Prishtina realizon më shumti të hyra në këtë sektor me rreth 39% të të hyrave të tërë sektorit, dhe gjatë vitit 2020 kishte një rritje të lehtë të të hyrave me rreth 1.2% krahasuar me vitin 2019. Përveç KRU Prishtinës, rritje në të hyra në vitin 2020 ka pasur edhe KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Hidrodrini dhe KRU Bifurkacioni. Ndërsa, KRU-të që kanë pasur rënie në të hyra janë KRU Hidromorava, KRU Mitrovica, KRU Gjakova dhe KU Drini i Bardhë. Shpenzimet e stafit përfshijnë pagat e punëtorëve, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e trajnimit, shpenzimet e sigurimit shëndetësor, shpenzimet e konferencave, si dhe shpenzimet tjera që bëjnë kompanitë në favor të punëtorëve. Nga kompanitë publike të ujësjellësit, shpenzimet më të mëdha në staf i ka KRU Prishtina, e cila gjatë vitit 2020 ka rritje në shpenzime me 6.36%. Kompanitë tjera në sektorin e ujësjellësit, në përgjithësi, me kalimin e viteve kanë pasur trend pozitiv në rritjen e shpenzimeve të stafit, ku gjithsej këto shpenzime, gjatë vitit 2020, kanë shkuar në shifrën prej 17.2 milionë eurove apo 2.87% më shumë sesa që ishin në vitin paraprak 2019.

Te kompanitë publike që bëjnë pjesë në sektorin e ujërave, vërehet se një numër mjaft i madh i tyre operon me humbje në treg. Kjo vjen kryesisht si pasojë e shkallës së ulët të arkëtimit të të hyrave, si dhe faturimit të ulët të shërbimeve që ato i ofrojnë. Gjatë vitit 2020, kompanitë publike që bëjnë pjesë në sektorin e ujërave operojnë me fitim mbi 101 mijë euro, rënie kjo me -84.9% krahasuar me vitin paraprak, kur këto kompani operonin me një fitim neto prej 669 mijë eurove. Kjo rënie kaq e madhe në fitim gjatë vitit 2020, ka ardhur kryesisht për shkak të performancës së dobët financiare të KRU Hidromorava, KRU Mitrovica, KRU Gjakova, KU Drini i Bardhë dhe KU Dukagjini.

Shkalla e faturimit dhe arkëtimit të shërbimeve nga ana e sektorit të ujërave

Një nga problemet më të mëdha me të cilën përballen kompanitë rajonale të ujësjellësit mbetet shkalla e ulët e faturimit dhe arkëtimit të shërbimeve që ato i ofrojnë. Që nga viti 2010, KRU Prishtina, KRU Hidromorava, KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Mitrovica, KRU Hidrodrini, KRU Bifurkacion kanë faturuar nën 50% të ujit të prodhuar⁷, duke lënë kështu të kuptohet se më shumë se gjysma e ujit të prodhuar është shpërndarë me humbje. Këto humbje në faturimin e shërbimeve të ofruara nga ana e KRU-ve ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të tyre, performancën operacionale, si dhe cilësinë e ofrimit të shërbimive. Në një periudhë kohore pesëvjeçare, e vetmja KRU që ka arritur të faturojë më shumë se gjysmën e ujit të prodhuar, ka qenë KRU Gjakova, e cila nga 39% e ujit të faturuar në vitin 2010, ka arritur

⁷ Me përjashtim për vitet 2019 dhe 2020 kur KRU "Hidromorava" e ka rritur faturimin në 50% dhe 53%, respektivisht.

në kuotën prej 52% në vitin 2015. Ndërsa, në rast se shikohet periudha dhjetëvjeçare, kompanitë rajonale të ujësjellësit që kanë shënuar progres në faturim të shërbimeve krahasuar me vitin 2010, mbeten KRU Hidromorava, KRU Hidrodrini, KRU Hidroregjioni Jugor.

KRU Prishtina, së bashku me KRU Bifurkacioni, janë të vetmet prej KRU-ve që kanë shënuar regres në përqindjen e shërbimeve të faturuara. Për shembull, KRU "Prishtina" nga 45% e ujit të faturuar në vitin 2010, dhjetë vite më vonë ka faturuar vetëm 42% të ujit të prodhuar. Ndërsa, KRU Bifurkacioni nga 40% e shërbimeve të faturuara në vitin 2010, gjatë vitit 2020 ka faturuar 37% të shërbimeve. KRU Mitrovica, përkundër luhatjeve gjatë viteve, përqindjen e shërbimeve të faturuara në vitin 2020 e ka të njëjtë me atë të vitit 2010. Dy kompanitë e tjera të ujësjellësit, KU Drini i Bardhë dhe KU Dukagjini janë kompani që merren me ofrimin e shërbimeve të ujitjes, prandaj edhe përqindja e faturimit të shërbimeve është maksimale (Tabela 3.)

Tabela 4. Shkalla e faturimit të shërbimeve në sektorin e ujërave

Faturimi i shërbimeve (%)							
Ndërmarrjet	2010	2015	2016	2017	2018	2019	2020
KRU "Prishtina"	45	49	47	43	40	42	42
KRU "Hidromorava"	40	39	42	43	47	50	53
KRU "Hidroregjioni Jugor"	42	42	42	42	43	44	45
KRU "Mitrovica"	47	40	38	38	41	45	47
KRU "Hidrodrini"	28	34	35	36	38	41	41
KRU "Gjakova"	39	52	53	53	56	57	58
KRU "Bifurkacioni"	40	/	/	/	/	35	37
KU "Drini i Bardhë"	/	100	100	100	100	100	100
KU "Dukagjini"	35	100	100	100	100	100	100

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

KU Drini i Bardhë mbetet si kompania më jostabile sa i përket arkëtimit të shërbimeve, ku luhatjet nga viti në vit kanë qenë mjaft të mëdha. Ndërsa, KU Dukagjini, prej vitit 2016 deri në vitin 2020, nivelin e arkëtimit të shërbimeve e ka pasur kryesisht në një mesatare mbi 90%.

Tabela 5. Shkalla e arkëtimit të shërbimeve në sektorin e ujërave

Arkëtimi i shërbimeve (%)							
Ndërmarrjet	2010	2015	2016	2017	2018	2019	2020
KRU "Prishtina"	70	76	90	87	97	96	83
KRU "Hidromorava"	68	78	82	80	84	96	86
KRU "Hidroregjioni Jugor"	69	74	87	95	96	94	92
KRU "Mitrovica"	55	56	60	57	72	84	72
KRU "Hidrodrini"	59	73	78	80	87	94	86
KRU "Gjakova"	66	84	95	87	97	98	95
KRU "Bifurkacioni"	61	/	/	/	/	87	72
KU "Drini i Bardhë"	/	22	49	63	31	26	63
KU "Dukagjini"	67	61	168	93	90	93	88

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Performanca financiare e sektorit të telekomunikimit dhe shërbimeve postare

Sektori i telekomunikimit dhe shërbimeve postare është një sektor i cili gjithmonë ka gjeneruar të hyra për shkak të volumit të madh të aktivitetit dhe mbulueshmërisë në të gjithë vendit. Momentalisht, në Kosovë, dy ndërmarrjet që bëjnë pjesë në këtë sektor dhe janë nën pronësinë e shtetit mbeten Telekom i Kosovës dhe Posta e Kosovës.

Tabela 6. Performanca financiare e ndërmarrjeve publike që bëjnë pjesë në sektorin e telekomunikimit dhe shërbimeve postare

Ndërmarrjet	2019	2020	Ndryshimi në përqindje
Të hyrat ('000 euro)			
"Telekomi i Kosovës" ShA (TK)	53,589	51,700	-3.52% ▼
"Posta e Kosovës" ShA (PK)	12,136	11,447	-5.68% ▼
Total të hyrat	65,725	63,147	-3.92% ▼
Shpenzimet në staf ('000 euro)			
"Telekomi i Kosovës" ShA (TK)	29,462	26,227	-10.98% ▼
"Posta e Kosovës" ShA (PK)	9,121	8,895	-2.48% ▼
Total shpenzimet në staf	38,583	35,122	-8.97% ▼
Fitimi/humbja neto ('000 euro)			
"Telekomi i Kosovës" ShA (TK)	-26,916	-18,727	30.42% ▲
"Posta e Kosovës" ShA (PK)	-990	-978	1.21% ▲
Gjithsej fitimi/humbja	-27,906	-19,705	29.39% ▲

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Si në vitin 2019, ashtu edhe në vitin 2020, Telekom i Kosovës ka realizuar të hyra mbi 50 milionë euro. Viti 2020 mund të konsiderohet si vit jo i suksesshëm për dy ndërmarrjet pasi të hyrat krahasuar me vitin paraprak kanë rënë për 3.52% te Telekom i Kosovës dhe 5.68% te Posta e Kosovës. Gjatë këtij viti, kjo rënie në të hyra vjen kryesisht si pasojë e efekteve zinxhimore në ekonomi që i ka shkaktuar pandemia COVID-19.

Sa i përket shpenzimeve në staf, del se dy ndërmarrjet publike që bëjnë pjesë në sektorin e telekomunikimit dhe shërbimeve postare, me kalimin e viteve kanë ulur këtë kategori. Kosto e punës së punëtorëve të tyre në total për këto dy ndërmarrje, gjatë vitit 2019, ka qenë 38.5 milionë euro, për të rënë në 35.1 milionë euro një vit më vonë, apo rënie prej 8.97%. Ndryshimin më të madh në përqindje e ka ulja e shpenzimeve në staf nga ana e Telekomit të Kosovës, e cila gjatë vitit 2020, ka ulur këto shpenzime me 10.98%, ndërsa Posta e Kosovës ka ulur shpenzimet e stafit me 2.48% krahasuar me vitin paraprak.

Telekomi dhe Posta janë dy ndërmarrje publike të cilat operojnë me humbje në treg. Përkundër kësaj, gjatë vitit 2020, Telekom i Kosovës ka bërë përmirësim në gjendjen e saj me plus 30.42% (në krahasim me vitin paraprak), ndërsa për Postën e Kosovës gjatë vitit 2020, përmirësimi në performancë ka qenë mjaft i ulët, përkatësisht me plus 1.21% (Tabela 5).

Performanca financiare e sektorit të transportit hekurudhor

Sektori i hekurudhave në Kosovë përbëhet nga dy ndërmarrje publike "Trainkos-i" dhe "Infrakos-i". Ky sektor është shumë i rëndësishëm për vendin pasi përveç transportit të qytetarëve, shërben edhe si një ndër burimet kryesore të transportit të mallrave dhe urë lidhëse mes qyteteve të Kosovës. Megjithatë, përkundër përfitimeve që sjell, ky sektor është mjaft i kushtueshëm për shkak të kostos së lartë të mirëmbajtjes së hekurudhave, si dhe nevojës së krijimit të linjave të reja hekurudhore.

Tabela 7. Performanca financiare e ndërmarrjeve publike që bëjnë pjesë në sektorin e transportit hekurudhor

Ndërmarrjet	2019	2020	Ndryshimi në përqindje
Të hyrat ('000 euro)			
"Trainkos" ShA	4,302	4,100	-4.70% ▼
"Infrakos" ShA	3,595	2,862	-20.39% ▼
Total të hyrat	7,897	6,962	-11.84% ▼
Shpenzimet në staf ('000 euro)			
"Trainkos" ShA	1,811	1,770	-2.26% ▼
"Infrakos" ShA	2,079	1,976	-4.95% ▼
Total shpenzimet në staf	3,890	3,746	-3.70% ▼
Fitimi/humbja neto ('000 euro)			
"Trainkos" ShA	-160	230	243.75% ▲
"Infrakos" ShA	-164	-625	-281.10% ▼
Total fitimi/humbja	-324	-395	-21.91% ▼

Burimi: Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Sa i përket realizimit të të hyrave, të gjitha ndërmarrjet publike që bëjnë pjesë në sektorin e transportit hekurudhor kanë shënuar rënie krahasuar me vitin 2019. Për shembull, shikuar në të dhënat e tabelës së mësipërme vërejmë se viti 2020, ka qenë mjaft i vështirë për "Infrakos"-in që është përballur me rënie të të hyrave për -20.39%, rënie kjo që vjen kryesisht për shkak të karantinës dhe efekteve zinxhirore që i ka shkaktuar pandemia COVID-19. Ngjashëm, edhe "Trainkos" është përballur me trend negativ të realizimit të të hyrave gjatë këtij viti, ku të hyrat kanë shënuar rënie me -4.70%.

Shpenzimet në staf të ndërmarrjeve publike që bëjnë pjesë në sektorin e transportit hekurudhor në përgjithësi kanë filluar të bien, rënie kjo me -3.70% gjatë vitit 2020, krahasuar me shpenzimet e vitit paraprak 2019. Vitin 2020, 'Infrakos'-i e ka përmbyllur me 4.95% më pak shpenzime në staf sesa shpenzimet që i kishte në vitin 2019, ndërsa 'Trainkos'-i, shpenzimet e stafit i kishte për 2.26% më të ulëta.

Përfundimisht vitit 2019, "Trainkos" ka operuar me fitim në treg, ku viti 2020 ka dalur të jetë mjaft fitimprurës me fitim neto plus 243.75%. Në anën tjetër, krejt e kundërta ka ndodhur te "Infrakos"-i, ku po i njëjti vit (2020) ka sjellur një ulje të fitimit neto me minus 281.10%, krahasuar me vitin 2019. Në total, këto dy ndërmarrje që bëjnë pjesë në këtë sektor, vitin 2020 e kanë përmbyllur me 21.91% më pak fitim neto sesa fitimi që e kishin në vitin paraprak.

Performanca financiare e sektorit të energjisë dhe minierave

Sektori i energjisë dhe minierave përshin burimet natyrore dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me to siç janë: sigurimi i energjisë elektrike dhe prodhimi i mineraleve dhe metaleve që janë të domosdoshme për funksionimin e industrisë së vendit. Si rrjedhojë, roli i Qeverisë në menaxhimin e këtyre aseteve strategjike është mjaft i madh. Ndërmarrjet publike qendrore të cilat e përbëjnë sektorin e energjisë dhe minierave në Kosovë janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe Trepça.

Tabela 8. Performanca financiare e ndërmarrjeve publike që bëjnë pjesë në sektorin e energjisë dhe minierave

Ndërmarrjet	2019	2020	Ndryshimi në përqindje
Të hyrat ('000 euro)			
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK)	185,135	193,267	4.39% ▲
"Trepça"	14,424	14,365	-0.41% ▼
Total të hyrat	199,559	207,632	4.05% ▲
Shpenzimet në staf ('000 euro)			
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK)	56,332	54,169	-3.84% ▼
"Trepça"	12,313	12,958	5.24% ▲
Total shpenzimet për staf	68,645	67,127	-2.21% ▼
Fitimi/humbja neto ('000)			
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK)	19,222	23,784	23.73% ▲
"Trepça"	-3,467	-4,730	-36.43% ▼
Total fitimi/humbja	15,755	19,054	20.94% ▲

Burimi: Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Të hyrat e realizuara nga ndërmarrjet që operojnë në fushën e energjisë dhe minierave kanë qenë mjaft të mëdha dhe me trend pozitiv rritës në total. Njëherit, KEK është edhe ndërmarrja publike që gjeneron më së shumti të hyra në Kosovë. Vitin 2020, kjo ndërmarrje e ka përmbyllur me 4.39% më shumë të hyra sesa që kishte në vitin paraprak 2019. Në anën tjetër, Trepça, gjatë vitit 2020, gjenerimin e të hyrave e kishte 0.41% më të ulët se në vitin 2019. Në përgjithësi, ndërmarrjet që bëjnë pjesë në sektorin e energjisë dhe minierave kanë pasur trend pozitiv në rritjen e të hyrave të tyre, ku viti 2020 ka sjellur një rritje të të hyrave me 4.05% për dy ndërmarrjet publike të këtij sektori.

Sa i përket shpenzimeve në staf, nga të dhënat e tabelës së mësipërme del se në përgjithësi ndërmarrjet e sektorit të energjisë dhe minierave i kanë ulur ato për 2.21% gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin paraprak. Trepça është e vetmja ndërmarrje në këtë sektor që ka pasur një rritje të shpenzimeve në staf gjatë vitit 2020, me 5.24% krahasuar me vitin paraprak 2019. Ndërsa, KEK-u ka ulur shpenzimet e stafit me minus 3.84% krahasuar me shpenzimet që i kishte në vitin 2019.

Ndërkaq, e vetmja ndërmarrje që bën pjesë në këtë sektor dhe operon me fitim në treg është KEK-u. Nga viti 2019 del se kjo ndërmarrje ka rritur fitimin e saj, me 23.73% më shumë të hyra gjatë vitit 2020. Sa i përket Trepçës, kjo ndërmarrje ka operuar gjithmonë me humbje, humbje këto të thelluara edhe më shumë gjatë vitit 2020 me 36.43%.

Performanca financiare e ndërmarrjeve multisektoriale

Ndërmarrjet publike multisektoriale janë ato ndërmarrje të cilat kryejnë më shumë se një veprimtari në treg. Në Kosovë, e vetmja ndërmarrje multisektoriale që është në pronësi të shtetit mbetet Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër-Lepenci. Detyra kryesore e kësaj ndërmarrje është furnizimi me ujë të papërpunuar i industrisë, bujqësisë, si dhe prodhimi i energjisë elektrike.

Tabela 9. Performanca financiare e ndërmarrjeve publike që bëjnë pjesë në sektorin e ndërmarrjeve multisektoriale

Ndërmarrjet	2019	2020	Ndryshimi në përqindje
Të hyrat ('000 euro)			
NH "Ibër – Lepenci"	5,386	4,580	-14.96% ▼
Shpenzimet në staf ('000 euro)			
NH "Ibër – Lepenci"	3,208	3,203	-0.16% ▼
Fitimi/humbja neto ('000)			
NH "Ibër – Lepenci"	3,753	4,123	9.86% ▲

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Nga rezultatet e tabelës së mësipërme del se NH Ibër-Lepenci ka realizuar 14.96% më pak të hyra gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019. Kjo rënie e të hyrave gjatë këtij viti ka ndodhur kryesisht për shkak të prodhimtarisë më të ulët si rezultat i pandemisë COVID-19. Sa i përket shpenzimeve në staf, NH Ibër-Lepenci gjatë vitit 2020, ka paguar 0.16% më pak për kostot e stafit në raport me vitin 2019. NH Ibër-Lepenci është një ndërmarrje publike e cila operon me fitim në treg. Në raport me vitin 2019, gjatë vitit 2020, trendi pozitiv i rritjes së fitimit të kësaj ndërmarrje është rritur me 9.86%.

Performanca financiare e sektorit të mbeturinave

Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive (KMDK) është një ndërmarrje publike qendrore e cila ka si qëllim organizimin dhe menaxhimin e deponive komunale në Republikën e Kosovës. Tabelat e mëposhtme paraqesin performancën financiare të kësaj ndërmarrje gjatë vitit 2019 dhe vitit 2020.

Tabela 10. Performanca financiare e ndërmarrjeve publike që bëjnë pjesë në sektorin e mbeturinave

Ndërmarrjet	2019	2020	Ndryshimi në përqindje
Të hyrat ('000 euro)			
Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive ShA (KMDK)	3,689	2,368	-35.81% ▼
Shpenzimet e staft ('000 euro)			
Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive ShA (KMDK)	745	768	3.09% ▲
Fitimi/humbja neto ('000)			
Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive ShA (KMDK)	1,056	112	-89.39% ▼

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duket se pandemia COVID-19 e ka goditur mjaft shumë këtë kompani duke i shkaktuar asaj një ulje të të hyrave gjatë vitit 2020 me 35.81%, krahasuar me vitin 2019. Përkatësisht, nga 3.7 milionë euro sa i kishte të hyrat në vitin 2019, gjatë vitit 2020, kjo kompani arriti të gjenerojë vetëm 2.36 milionë euro, përkatësisht rreth 1.3 milionë euro më pak. Sa i përket shpenzimeve në staf, KMDK gjatë vitit 2020, ka rritur shpenzimet me 3.09% krahasuar me vitin paraprak, rritje kjo prej 23 mijë eurove, duke i çuar kështu shpenzimet totale në 768 mijë euro.

Viti 2020 ka qenë mjaft i dëmshëm për KMDK, ku si pasojë e pandemisë COVID-19 kësaj ndërmarrje i është ulur fitimi me 89.39% krahasuar me vitin paraprak 2019. Pra, nga 1.05 milionë euro fitim sa i kishte gjatë vitit 2019, kjo ndërmarrje në vitin 2020 pati vetëm 112 mijë euro fitim.

Numri i punëtorëve të ndërmarrjeve publike

Numri i punëtorëve në një ndërmarrje publike varet nga veprimtaria e ndërmarrjes dhe niveli i punës që ndërmarrja ofron. Ky numër i punëtorëve ndryshon nga viti në vit, për shkak të lëvizjeve të stafit, konkurseve të reja të punësimit, pensionimit të punëtorëve aktiv etj.

Tabela 11. Numri i punëtorëve në sektorin e ujërave

Ndërmarrjet	2019	2020
KRU "Prishtina"	586	557
KRU "Hidromorava"	165	159
KRU "Hidroregjioni Jugor"	332	337
KRU "Mitrovica"	260	252
KRU "Hidrodrini"	216	218
KRU "Gjakova"	274	287
KRU "Bifurkacioni"	206	212
KU "Drini i Bardhë"	35	34
KU "Dukagjini"	65	72
"Telekomi i Kosovës" ShA (TK)	2,383	2,288
"Posta e Kosovës" ShA (PK)	1,012	966
"Trainkos" ShA	230	227
"Infrakos" ShA	308	286
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK)	4,003	3,884
"Trepça"	1,161	1,372
NH "Ibër – Lepenci"	311	304
Kompania e Kosovës për Menaxhimin e Deponive ShA (KMDK)	83	86
TOTAL	11,630	11,541

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e NjPMNP

Gjetjet kryesore të Zyrës Kombëtare të Auditimit në NP

Zyra Kombëtare e Auditorit nuk pasqyron mbi baza vjetore raporte të performancës apo të rregullsisë për gjitha ndërmarrjet publike. Nga viti 2011 deri në vitin e fundit 2019 nuk është realizuar asnjë auditim për ndërmarrjet publike me shtrirje kombëtare. Përfshirë bëjnë ndërmarrjet rajonale të ujësjellësëve, për të cilat, ZKA harton dhe publikon raporte mbi baza vjetore, si dhe për Radio Televizionin e Kosovës.

Në vitin 2020, në planin e punës, ZKA ka përfshirë auditimin e një numri të NP-ve në mesin e të cilave KEK-un (auditim në fushën e prokurimit publik), Telekomin e Kosovës, Postën e Kosovës, Infrakosin, Trainkosin, KRM Uniteti, Termokos, Iber-Lepenci, KRM Pastrimi, si dhe ndërmarrjen publike banesore në Prishtinë.⁸

Nga ZKA për pjesën më të madhe të këtyre ndërmarrjeve kanë marrë opinion të "i kundërt", apo opinion i cili tregon se auditori ka gjetur gabime sistematike në menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, aseteve, resurseve humane dhe në përmbushjen e objektivave në forcimin dhe modernizimin e ndërmarrjeve.⁹

Nga gjetjet kryesore, përveç operimit me humbje, dalin të jenë edhe gabime në regjistrimin e konsumatorëve, gabime në evidentimin e të hyrave financiare, gabime në regjistrimin e pagesave që kryjnë konsumatorët, mos evidentimi i shpenzimeve kontigjente dhe mungesë të dhënash që lidhen me paditë në gjykata nga palët e jashtme, gabime sistematike në menaxhimin e resurseve humane, regrutimi i stafit në kundërshtim me rregullat e konkurseve, shpërfillje e rregullave të prokurimit publik, aplikimi i standardeve të dyshimta dhe kontradiktore në faturim, falje të borxheve pa mbulushmëri ligjore, investime në asete që nuk shfrytëzohen, e deri të rastet e gabimeve financiare që janë hasur me avance, mos evidentim i vijueshmërisë në punë apo rezultateve gjatë punës, mos mbulimi i trustit pensional për të punësuarit si dhe vonesa të mëdha në hartimin dhe paraqitjen e raporteve financiare.

⁸ Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti vjetor. Fq 107. Burimi: <https://bit.ly/3YeezCh>

⁹ Po aty

Transparenca e ndërmarrjeve publike

Transparenca e punës, shërbimeve dhe shpenzimeve është tregues i llogaridhënies institucionale dhe qeverisjes së mirë. Ndërmarrjet publike në Kosovë vlerësohen të kenë mangësi serioze në këtë drejtim dhe kjo vjen për dy arsye: e para, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve nuk kanë të emëruar zyrtarë përgjegjës për komunikim me palët e jashtme, duke përfshirë komunikimin me mediat, po ashtu mungojnë zyrtarët e caktuar për t'u mundësuar palëve të jashtme qasje në të dhënat publike; e dyta, mungojnë një numër i madh i dokumenteve që do të duhet të ishin publike në faqen e tyre zyrtare në internet.

Në këtë drejtim nuk bën përjashtim as NjPMNP në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, e cila dokumentet e fundit të vendosura në faqen e saj që lidhen me ndërmarrjet publike janë të vitit 2018.¹⁰ Kjo njësi nuk publikon tash e disa vite as raportin e performancës për ndërmarrjet publike, me arsyetimin se nuk janë aprovuar në Kuvend.

Neni 31.3 i Ligjit për ndërmarrjet publike përcakton se brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, zyrtarët e NP, në do të përgatisin dhe dorëzojnë bordit të drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmëria e përgjithshme në realizimin e caceve të vendosura në planin e biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimi të raportit vjetor, bordi i drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë, miratojë dhe dorëzojë raportin vjetor tek Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet. Po ashtu do t'i publikojë raportet vjetore në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP".¹¹

¹⁰ Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Njësia për Politikën dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Faqja zyrtare.

Pjesa e dokumenteve. Burimi: <https://bit.ly/3FJEaM8>

¹¹ Gazeta Zyrtare e Kosovës. Ligji për Ndërmarrjet Publike. Burimi: <https://bit.ly/3hjz8N9>

Tabela 12. Informatat e publikuara në uebfaqet e ndërmarrjeve publike (kontrolluar dhjetor 2022)

	Ueb faqe funksionale	Personi për sinjalizim (kontakti në faqen zyrtare)	Publikimi i të dhënave nga prokurimi	Shpjegime në faqen zyrtare për shërbimet që ofrohen	Raporti vjetor financiar/ detajuar (2020-2021)	A publikohet raporti i performancës së bordeve (2020 & 2021)	Publikimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve
KEK	✓	✓	✗	✓	✓	✗	✗
Telekomi	✓	✓		✓	✗	✗	✗
Trainkos	✓	✗	✗	✓	✓	✗	✗
Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave	✓	✗	✓	✓	✗	✗	✗
Iber-Lepenci	✓		✗	✓	✓	✗	✗
RTK	✓	✗	✗	✓	✓	✗	✗
Infrakos	✓					✗	✗
Aeroporti (kontrolli ajror)	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Trepça	✓	✗	✗	✓		✗	✗
Posta	✓	✗	✓	✓	✗	✗	✗
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut	✓	✗	✓	✓	✓	✗	✗
KU Drini i Bardhë	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
KU Radoniqi	✓		✗	✓	✗	✗	✗
KRU Prishtina	✓	✓		✓	✓	✗	✓
KRU Hidrodrini	✓	✗	✓	✓	✓	✗	✗
KRU Hidroregjioni Jug	✓	✓		✓	✓	✗	✗
KRU Mitrovica	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
KRU Hidromorava	✓	✓	✗	✓	✓	✗	✗
KRU Radoniqi	✓	✗	✓	✓	✓	✗	✗

✓ Është publikuar
 ✗ Nuk është publikuar,
 ||| pjesërisht i publikuar.

Përfundim

Nga të dhënat e paraqitura tregohet se ndërmarrjet publike qendrore vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme, duke nisur nga problemi me i madh i tyre, operimi me humbje në treg. Kjo pastaj percillet me vështirësi të kryerjes se investimeve dhe modernizim të paisjeve dhe shërbimeve.

Njeri nga sektorët me të rëndësishëm në këtë drejtim është ai i ujrave. Te këto kompani, vërehet se perqindja më e madhe e tyre operon me humbje. Ky operim me humbje vjen kryesisht si pasojë e shkallës së ulët të arkëtimit të të hyrave, si dhe faturimit të ulët të shërbimeve që ato i ofrojnë. Në total gjatë vitit 2020, kompanitë publike që bëjnë pjesë në sektorin e ujërave operojnë me fitim mbi 101 mijë euro, rënie prej 84.9% krahasuar me vitin paraprak kur këto kompani operonin me një fitim neto prej 669 mijë eurove. Kjo rënie kaq e madhe në fitim gjatë vitit 2020, ka ardhur kryesisht për shkak të performancës së dobët financiare të KRU Hidromorava, KRU Mitrovica, KRU Gjakova, KU Drini i Bardhë dhe KU Dukagjini.

Sektori i hekurudhave në Kosovë përbëhet nga dy ndërmarrje publike "Trainkos-i" dhe "Infrakos-i". Ky sektor është shumë i rëndësishëm për vendin pasi përveç transportit të qytetarëve, shërben edhe si një ndër burimet kryesore të transportit të mallrave dhe urë lidhëse mes qyteteve të Kosovës. Megjithatë, përkundër përfitimeve që sjell, ky sektor është mjaft i kushtueshëm për shkak të kostos së lartë të mirëmbajtjes së hekurudhave, si dhe nevojës së krijimit të linjave të reja hekurudhore. Sa i përket realizimit të të hyrave, në total ndërmarrjet publike që bëjnë pjesë në sektorin e transportit hekurudhor kanë shënuar rënie krahasuar me vitin 2019. Për shembull, në vitin 2020, ka qenë mjaft i vështirë për "Infrakos"-in që është përballur me rënie të të hyrave për 20.39%, rënie kjo që vije kryesisht për shkak efekteve zinxhirore që i ka shkaktuar pandemia COVID-19. Ngjashëm edhe "Trainkos" është përballur me trend negativ të realizimit të të hyrave gjatë këtij viti, ku të hyrat kanë shënuar rënie prej 4.70%.

Probleme të ndryshme janë hasur edhe në sektorin e energjisë dhe minierave dhe sektor të mbeturinave. Përveç aspektit operativ të NP-ve, problem mbetet edhe mos përmirësimi i vlerësimit që marrin këto ndërmarrje nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Numri më i madh i ndërmarrjeve të audituara kanë marrë opinion të "kundërt" në raportet e auditimit të ZKA, apo opinion i cili tregon se auditori ka gjetur gabime sistematike në menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, aseteve, resurseve humane dhe në përmbushjen e objektivave në forcimin dhe modernizimin e ndërmarrjeve.

Edhe mungesa e transparencës dhe mungesa e kapaciteteve të NP për bashkëpunim me palët e jashtme, del të jetë një problem i vazhdueshëm. Kjo vije për dy arsye, e para, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve nuk kanë të emëruar zyrtar përgjegjës për komunikim me palët e jashtme, duke përfshirë komunikimin me mediat, po ashtu mungon zyrtari i caktuar për t'u mundësuar palëve të jashtme qasje në të dhënat publike. Arsya e dytë qendron të fakti se një numër i madh i dokumenteve që do të duhet të ishin publike në faqen e tyre zyrtare në internet mungojnë si publikim.

Aneks

Tabela 13. Lista e ndërmarrjeve publike

Ndërmarrje publike Qendrore	
Ndërmarrje publike	Ndërmarrje regjionale
KEK	KU "Drini i Bardhë"
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut	KU "Radoniqi"
Telekomi	KRM "Prishtina"
Trainkos	KRU "Hidrodrini"
Kompania për Menaxhimin e Deponive	KRU "Hidroregjioni Jugor"
Iber-Lepenci	KRU "Mitrovica".
Aeroporti i Gjakovës	KRU "Hidromorava"
Infrakos	KRU "Radoniqi"
Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (Kontrolli Ajror)	KRU "Bifurkacioni"
Trepça	
Posta e Kosovës	
NKEC	
Ndërmarrje lokale	
Ndërmarrje lokale	Ndërmarrje rajonale
Ngrohtorja e qytetit Termokos (Prishtinë).	KRM "Pastrimi"
Ngrohtorja e qytetit Gjakova.	KRM "Ambienti"
Kompania e mbeturinave "Standard" - Mitrovicë.	KRM "Pastërtia"
Kompania e mbeturinave – Zveçan.	KRM "Eco-Regjion"
Kompania e ujësjellësit dhe mbeturinave "Ibri", Zubin Potok.	KRM "Higjiena"
Kompania e ujësjellësit dhe mbeturinave "24 Nëntori" Leposaviq.	KRM "Uniteti"
Ndërmarrja publike banesore, Prishtinë.	KRM "Çabratë"
Kompania "Tregu" Mitrovicë.	
Ndërmarrja "Prishtina Parking".	
Ndërmarrja "Kuzhina Qendrore" – Prishtinë.	
Ndërmarrja "Sport Marketing" – Prishtinë.	
Ndërmarrja "Ekologjia" Graçanicë.	
Qendra multifunksionale – Mitrovicë.	
Ndërmarrja "Tregu" Gjilan.	
Ndërmarrja "Higjiena" Deçan.	
Ndërmarrja "Përparimi" – Vushtri.	
Ndërmarrja "Eko-natyrë" Skenderaj.	
Ndërmarrja "Kastrioti" – Obiliq.	
Kompania "Hortikultura" – Prishtinë.	
Ndërmarrja publike për banim – Pejë.	
Ndërmarrja publike për banim – Prishtinë	
Ndërmarrja e trafikut urban – Prishtinë	
Ndërmarrja publike "Pallati i rinisë"	
"Omni Sport" – Mitrovicë e Jugut.	

Projekti "Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Rritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës" financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Instituti GAP (GAP), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhe nuk pasqyron domosdoshmerisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.

Projekt i mbështetur
nga:



British Embassy
Pristina

Projekt i implementuar
nga:



Group for Legal
and Political
Studies



INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Raport tematik

Menaxhimi financiar
dhe transparenca në
ndërmarrjet publike

12/2022



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies

